



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/204
Datë: 05.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-233 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Ministrit të Financave për kursimin e ndarjeve buxhetore për vitin 2014 në shumë prej 26,164,917 euro si vijon:
1. Shuma prej 14,034,216 euro kursim i ndarjeve buxhetore në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale në bazë të Listës së bashkangjitur nga Departamenti i Thesarit -Ministria e Financave
 2. Komisioni Kosovar i Konkurrencës, nga ndarjet buxhetore kursen 43,511 euro si në vijim:
 - 2.1. Shuma prej 43,511 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Komisioni Kosovar i Konkurrencës, me kod 116, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
 3. Zyra e Rregullatorit të Energjisë, nga ndarjet buxhetore kursen 61,865 euro si në vijim:
 - 3.1. Shuma prej 61,865 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Zyra e Rregullatorit të Energjisë, me kod 425, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
 4. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, nga ndarjet buxhetore kursen 555,000 euro si në vijim:

- 4.1. Shuma prej 5,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Instituti i Leposaviqit me kod 972, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje,
 - 4.2. Shuma prej 50,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin, Universiteti i Gjilanit, me kod 977, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje,
 - 4.3. Shuma prej 200,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin, Universiteti i Gjakovës, me kod 978, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje,
 - 4.4. Shuma prej 200,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin, Universiteti i Mitrovicës, me kod 979, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje,
 - 4.5. Shuma prej 100,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin, Arsimi me nevoja speciale, me kod 908, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
5. Këshilli Gjyqësor i Kosovës (328) nga ndarjet buxhetore kursen 250,000 euro si në vijim:
- 5.1. Shuma prej 250,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin e Gjykata dhe Sekretariati (333), kategoria ekonomike Shpenzimet Kapitale nga projekti "Dizajnimi dhe ndërtimi i objektit të Gjykatës Themelore në Ferizaj" me kod 13249.
6. Kuvendi (101), nga ndarjet buxhetore kursen 1,021,609 euro si në vijim:
- 6.1. Shuma prej 960,918 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Anëtarët e Kuvendit (101), kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
 - 6.2. Shuma prej 60,691 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Stafi Mbështetës Politik (158), kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
7. Ministria e Diasporës (219), nga ndarjet buxhetore kursen 15,716 euro si në vijim:
- 7.1. Shuma prej 15,716 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Administrata Qendrore (113), kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
8. Agjensioni Kundër Korrupsion (236), nga ndarjet buxhetore kursen 30,000 euro si në vijim:
- 8.1. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjensioni Kundër Korrupsion, kategoria ekonomike Mallrat dhe Shërbimet.
9. Komisioni i Pavarur i Mediave (319), nga ndarjet buxhetore kursen 6,000 euro si në vijim:

- 9.1. Shuma prej 6,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Komisioni i Pavarur i Mediave, kategoria ekonomike Paga dhe Mëditje.
10. Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (230), nga ndarjet buxhetore kursen 32,000 euro si në vijim:
 - 10.1. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, me kod 145, kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime.
 - 10.2. Shuma prej 2,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, me kod 145, kategoria ekonomike Shpenzime Komunale.
11. Ministria e Integrimit Evropian (218), nga ndarjet buxhetore kursen 115,000 euro si në vijim:
 - 11.1. Shuma prej 100,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Administrata Qendrore (113), kategoria ekonomike Mallra dhe Shërbime.
 - 11.2. Shuma prej 15,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Administrata Qendrore (113), kategoria ekonomike Shpenzime komunale.
12. Ministria e Financave (201), nga ndarja buxhetore kursen 10,000,000 euro si vijon:
 - 12.1. Shuma prej 10,000,000 euro, kursim nga nën-programi Kontigjenca për financimin e ish të dënuarve politik dhe veteranëve të luftës, me kod 254, kategoria ekonomike subvencione.

II. Mjetet nga pika I-rë këtij vendimi në vlerë prej 26,164,917 euro ndahen si vijon:

1. Shuma prej 21,000,000 euro në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transferove.

Obligohet MPMS t'i ofroj Ministrisë së Financave informatat e sakta për shpërndarjen e mjeteve nga pika II. 1 e këtij vendimi sipas nën-programeve.

2. Shuma prej 800,000 euro ndahet për Byronë e Sigurimeve të Kosovës dhe transferohen në Departamentin e Thesarit, MF, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

3. Shuma prej 10,000 euro në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për SHC, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime.

4. Shuma prej 2,354,917 euro, Universitetin e Prishtinës, kategoria ekonomike paga dhe mëditje.

5. Shuma prej 2,000,000 euro, Shpenzimet e paparashikuara, kategoria ekonomike- Rezervat.

III. 1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administratës Publike (202), për kursim dhe ndarje buxhetore në vitin 2014 në shumë prej €1,425,996, si në vijim:

1.1. Shuma prej 380,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "E-Qeverisja", me kod 10423.

1.2. Shuma prej 91,255 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Arkivimi Elektronik i Dokumenteve Shtetërore" me kod 10933.

1.3. Shuma prej 150,000 euro kursim ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Ngritja e resurseve të TI dhe avancimi i shërbimeve" kod 13442.

1.4. Shuma prej 200,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, projekti "Interoperabiliteti" me kod 12658.

1.5. Shuma prej 13,741 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126, kategoria ekonomike shpenzime kapitale "Sistemi telefonik qeveritar (VOIP)" me kod 12055.

1.6. Shuma prej 91,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126, kategoria ekonomike shpenzime kapitale "Zgjerimi i rrjetit qeveritar në të gjitha komunat e Kosovës" me kod 10011.

1.7. Shuma prej 500,000 euro kursim i ndarjes buxhetore në nën-programin Departamenti për Menaxhimin e Reformës në Administratën Publike DMRAP me kod 203, kategoria ekonomike shpenzime kapitale "Implementimi i planit të veprimit për reformë të administratës publike në Kosovë" me kod 12663.

1.8. Mjetet në shumë prej 1,425,996 euro transferohen në nën-programin Agjencia e Shoqërisë së informacionit ASHI-së me kod 126 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime.

2. Zbatohet Vendimi i Qeverisë Nr.18/181, datë 02/04.2014, për kursim dhe ndarjen e mjeteve buxhetore nga një organizatë buxhetore në një organizatë tjetër buxhetore në shumë prej 150,000 euro, si vijon:

2.1. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, me kod 212, nga nën-programi

Administrata qendrore, kodi 113, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere,

2.2. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore nga Ministria e Financave, me kod 201, nga nën-programi Administrata qendrore, kodi 113, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere,

2.3. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore nga Ministria e Drejtësisë, me kod 215, nga nën-programi Administrata qendrore, kodi 113, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere,

2.4. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me kod 208, nga nën-programi Administrata qendrore, kodi 113, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere,

2.5. Shuma prej 30,000 euro kursim i ndarjes buxhetore nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me kod 209, nga nën-programi me kod 006 Shërbimet sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere,

2.6. Mjetet në shumë prej 150,000 euro transferohen në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nën-programi me kod 006 Shërbimet sociale, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere,

3. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (203), për kursim në shumë prej 3,500,000 euro, si në vijim:

3.1. Shuma prej 3,500,000 euro kursim i ndarjes buxhetore nga nën-programi Departamenti i Politikave Bujqësore dhe Tregjeve me kod 401, kategoria ekonomike shpenzime kapitale, nga projekti "Rehabilitimi i Sistemit të Ujitjes

3.2. Mjetet në shumë prej 3,500,000 euro ndahen në të njëjtin nën-program, kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

IV. Obligohen Ministritë e ndikuara nga ky vendim dhe Ministria e Financave për zbatim të këtij vendimi.

V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/204

Datë: 05.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Drejtësisë për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 200,000.00 (dyqind mijë) euro me qëllim të pajisjes me inventar të objektit të Pallatit të Drejtësisë dhe sallave të gjykimit.
2. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e parashikuara dhe barten në Ministrinë e Drejtësisë në nën programin Administrata Qendrore me kode 113, Kategoria ekonomike Mallra e shërbime.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/204

Datë: 05.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për Ceremoninë e rivarrimit të eshtrave të heroit kombëtar Isa Boletini, nën patronatin e Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi, e cila do të organizohet më 28 nëntor 2014, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Kryesues;
 - 1.2. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Zëvendëskryesues;
 - 1.3. Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, anëtar;
 - 1.4. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Jashtme-Protokollit të Shtetit, anëtar;
 - 1.5. Përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme-Policisë së Kosovës, anëtar;
 - 1.6. Përfaqësuesi i Komunës së Mitrovicës, anëtar;
 - 1.7. Përfaqësuesi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, anëtar;
 - 1.8. Përfaqësuesi i Institutit të Historisë, anëtar;
 - 1.9. Përfaqësuesi i Familjes së Isë Boletinit, anëtar.
2. Për punën e Këshillit Organizativ ndahen mjete financiare në vlerë prej 50,000.00 euro, të cilat do të shfrytëzohen sipas nevojës për manifestim.
3. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Rezervat e Qeverisë, shpenzimet e parashikuara kategoria rezervat, dhe barten në kodin nr. 10700 në kategorinë ekonomike mallra dhe shërbime, në Zyrën e Kryeministrit.
4. Obligohet Ministria e Financave, Zyra e Kryeministrit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/204

Datë: 05.11.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 215 të Ligjit Nr. 04/L-149 për ekzekutimin e sanksioneve penale, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 5 nëntor 2014, mori:

V E N D I M

1. Z. Emrush Thaçi, emërohet Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues në Ministrinë e Drejtësisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjatë pesë (5) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë